

## ZJARRET NË PYJE

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 03) pritet nivel rrezik "I MODERUAR" në qarkun e Fierit, ndërsa në qarqet e tjera pritet nivel rrezik "I ULËT" dhe "S'KA RREZIK".

Në disa qarqe pritet rrezik "I MODERUAR" vetëm në zona të lokalizuara, konkretisht: qarku Lezhë (Jug-Perëndim), Durrës (Jug), Tiranë (Lindje), Elbasan (Perëndim), Berat (Veri-Perëndim) Korçë (Qendër) dhe Vlorë (Veri).

Nesër (e enjte, dt. 04) pritet nivel rrezik "S'KA RREZIK" në të gjithë qarqet.

## PARASHIKIMI METEO

### RESHJET

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 03) dhe nesër (e enjte, dt. 04) priten reshje mesatare deri lokalisht intensive në qarkun e Shkodrës. Në qarqet Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan dhe Vlorë priten reshje mesatare, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare. Reshjet pritet të shoqërohen me shtrëngata (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Shtrëngatat dhe intensiteti i lartë i reshjeve, mund të krijojnë probleme të ndryshme, si rrëshqitje të dherave dhe vërshime të ujit në zonat urbane të lokalizuara, në varësi të sistemit të kanalizimeve në qarqet Shkodër, Lezhë dhe Durrës.

### TEMPERATURA

Nesër (e enjte, dt. 04) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 18 / 22 °C

në vendet e ulëta: 17 / 24 °C

në vendet malore: 13 / 19 °C

### ERA

Sot pasdite (e mërkurë, dt. 03) dhe nesër (e enjte, dt. 04) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, ndërsa në bregdet dhe zonat malore deri e fortë.

**NIVELET E RREZIKUT**

**S'KA RREZIK**

**I ULËT**

**I MODERUAR**











**I LART**

**BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE** (*Bulletin on Natural Hazards*)  
**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**  
 Facebook page: [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: [www.geo.edu.al](http://www.geo.edu.al)

Buletini Nr. 154 / 2026, 03-06-2026

Parashikimi nga 03-06-2026, ora 12:00 deri 04-06-2026, ora 23:59.

**PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)**

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	I ULËT	mesatare	intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
DIBËR	S'KA RREZIK	të dobëta	mesatare				
LEZHË	I ULËT	mesatare					
DURRËS	I ULËT	mesatare					
TIRANË	I ULËT	mesatare					
ELBASAN	I ULËT	mesatare					
FIER	I MODERUAR	të dobëta					
BERAT	I ULËT	të dobëta					
KORÇË	I ULËT	të dobëta	mesatare				
VLORË	I ULËT	mesatare					
GJIROKASTËR	I ULËT	të dobëta	mesatare				



Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO


Specialist: Anira Gjoni

Koordinator: Elona Abazi (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: [albania.hazards@gmail.com](mailto:albania.hazards@gmail.com))

faqe 2 / 3

**LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe**

<b>Niveli i Rrezikut</b>	<b>Reshje shiu</b> (mm / 24 orë)
<b>S'KA RREZIK</b>	të dobëta (0 - 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I ULËT</b>	mesatare (15 - 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
<b>I MODERUAR</b>	intensive (45 - 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
<b>I LARTË</b>	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.



**LEGJENDA: Zjarre në pyje**

<b>S'KA RREZIK</b>	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
<b>ULËT</b>	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
<b>I MODERUAR</b>	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
<b>I LARTË</b>	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT për sot dhe nesër, dt. 03-04.**

**SIMBOLE**

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke